



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI KONTRAKTOR  
BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)**  
për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 09.06.2021

Për: **Operatorin Ekonomik “NERI” shpk, me NIPT J78423806C, me adresë Ballsh, Mallakastër**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i referencës: **REF-95198-05-11-2021**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje karburant (Diezel) viti 2021” (Për nevoja të Bashkisë Mallakastër dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike), me fond limit 16,851,666.7 (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.75, datë 17 maj 2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **Çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

1. Operatori Ekonomik **“KASTRATI” shpk, me NIPT J61813529P**, ka paraqitur ofertën të shprehur me marzh fitimi **6 %** (gjashtë përqind), me vlerë **16,851,666.7** (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “NERI” shpk, me NIPT J78423806C, ka paraqitur ofertën të shprehur me marzh fitimi **9.3 %** (nëntë pikë tre përqind), me vlerë **16,851,666.7** (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) **lekë pa TVSH.**

### **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

- 1. Operatori Ekonomik “KASTRATI” shpk, me NIPT J61813529P, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, në shtojcën 9 të Dokumentave Standarte të Tenderit, me pëmbajtje si më poshtë:

*“d. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, lëshuar prej njësisë/ve së qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitetin, referuar adresës kryesore dhe asaj/atyre dytësore sipas ekstraktit të QKB. (Në rast se ofertuesi është bashkim i operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).”*

Kjo kërkesë nuk plotësohet, pasi nuk janë paraqitur të gjitha vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020, për adresat dytësore të regjistruara në QKB, në të cilat subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitetet. Konkretisht, referuar të dhënave të pasqyruara në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar të QKB, rezulton se për vitin 2020, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitetet në adresat e mëposhtme:

- Në datën 17/08/2020 (Numri i çështjes: CN-575876-08-20), subjekti “KASTRATI” shpk ka shtuar adresë për ushtrim aktiviteti në: Lagjia Partizani, Zona Kadastrale 1326, me numër pasurie 3/428, ndërtesë 1 katëshe, Burrel, dhe e ka hequr këtë adresë në datën 24.02.2021 (Numri i çështjes: CN-663476-02-21). Pra, për këtë adresë, që i përket Bashkisë Mat, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitetet gjatë vitit 2020, por nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga kjo Bashki.
- Në datën 17/08/2020 (Numri i çështjes: CN-575876-08-20), subjekti “KASTRATI” shpk ka shtuar adresë për ushtrim aktiviteti në: Lagjia e re, Rruga e Arbërit, Vajkal, 100 metra nga mbikalimi, Zona Kadastrale 3694, me numër pasurie 2315/3, Bulqizë, dhe e ka hequr këtë adresë në datën 24.02.2021 (Numri i çështjes: CN-663476-02-21). Pra, për këtë adresë, që i përket Bashkisë Bulqizë, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitetet gjatë vitit 2020, por nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga kjo Bashki.
- Në datën 17/08/2020 (Numri i çështjes: CN-575876-08-20), subjekti “KASTRATI” shpk ka shtuar adresë për ushtrim aktiviteti në: Rruga nacionale Gramsh-Elbasan, Pishaj, Zona Kadastrale 2967, me numër pasurie 77/39, 77/40, 77/21, ndërtesë 1 katëshe, Gramsh, dhe e ka hequr këtë adresë në datën 24.02.2021 (Numri i çështjes: CN-663476-02-21). Pra, për këtë adresë, që i përket Bashkisë Gramsh, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitetet gjatë vitit 2020, por nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga kjo Bashki.
- Në datën 18/08/2020 (Numri i çështjes: CN-576429-08-20), subjekti “KASTRATI” shpk ka shtuar adresë për ushtrim aktiviteti në: Rruga Pogradec-Korçë, Lagjia 1, Zona Kadastrale 8581, me numër pasurie 10/716, ndërtesë 1 katëshe, Pogradec, dhe e ka hequr këtë adresë në datën 24.02.2021 (Numri i çështjes: CN-663476-02-21). Pra, për këtë

adresë, që i përket Bashkisë Pogradec, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2020, por nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga kjo Bashki.

- Gjithashtu, në datën 09/12/2020 (Numri i çështjes: CN-628968-12-20), subjekti “KASTRATI” shpk ka shtuar adresa për ushtrim aktiviteti në vendndodhje të ndryshme që i përkasin Bashkive Skrapar, Tropojë, Has, Peqin, Kolonjë dhe Kuçovë, adresa të cilat janë hequr gjatë muajit Shkurt 2021. Pra, për këto adresa, që i përkasin Bashkive Skrapar, Tropojë, Has, Peqin, Kolonjë dhe Kuçovë, subjekti “KASTRATI” shpk ka ushtruar aktivitet gjatë vitit 2020, por nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore nga këto Bashki.

***Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Operatori Ekonomik “KASTRATI” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.***

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “NERI” shpk, me NIPT J78423806C**, me adresë Ballsh, Mallakastër, se oferta e paraqitur, me marzh fitimi të shprehur në përqindje **9.3 %** (nëntë pikë tre përqind), me vlerë **16,851,666.7** (gjashtëmbëdhjetë milion e tetëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatë) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

***Duke qenë se ligji i zbatueshëm për këtë procedurë prokurimi është ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”, Njoftimi i Fituesit dërgohet për publikim në sistemin e prokurimit elektronik, në zbatim të pikës 1, të nenit 97 të këtij ligji.***

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 07.06.2021

Ankesa: Nuk ka patur

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**